



TÜRKİYE BİLİMLER AKADEMİSİ



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

**Memorandum mirëkuptimi
për bashkëpunim shkencor
ndërmjet Akademisë së Shkencave të Turqisë (TÜBA)
dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH)**

Akademia e Shkencave e Turqisë (TÜBA) dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH), të cilësuar më tej *Palët*; duke njohur rëndësinë e përfitimit të ndërsjellë nga bashkëpunimi; vendosin të nënshkruajnë këtë *Memorandum mirëkuptimi* (më tej *MoU*), për të stabilizuar bashkëpunimin e tyre të mëtejshëm shkencor.

Palët shprehin bindjen se bashkëpunimi ndërmjet tyre do të kontribuojë në mënyrë efektive për shkëmbimin e informacionit shkencor midis bashkësive shkencore të Turqisë dhe Shqipërisë. Bashkëpunimi përfshin të gjitha disiplinat shkencore dhe realizohet në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta dhe në përputhje me përgjegjësitë e dy *Palëve*.

Neni 1

Qëllimi, objektivi dhe synimet

Qëllimi i këtij memorandumi është të nxisë bashkëpunimin ndërmjet *Palëve*. Objektivat e këtij MoU janë:

- të forcojë bashkëpunimin akademik ndërmjet *Palëve*;
- të inkurajojë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës shkencore mes *Palëve*, nëpërmjet ndërveprimeve midis kërkuesve e studiuesve të tyre, në mënyrë që të zhvillojnë aktivitete bashkëpunuese në vendet e njëri-tjetrit;
- të lehtësojë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet kërkuesve të *Palëve* në fushat me interes të përbashkët;
- të nxisë bashkëpunimin ndërmjet kërkuesve të *Palëve*, me synimin për t'i shndërruar rezultatet e kërkimeve të tyre avancuara në aplikacione me përfitim, që çojnë në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës;

- të inkurajojë ndarjen e praktikave më të mira mes studiuesve të *Palëve*.

Bashkëpunimi mund të shtrihet e të mbulojë të gjitha fushat e spektrit akademik: shkencat teknike dhe teknologjinë; shkencat humane, duke përfshirë mjekësinë, dhe shkencat sociale në përgjithësi.

Neni 2

Format e bashkëpunimit

Palët promovojnë bashkëpunimin shkencor e teknologjik përmes:

- takimeve shkencore dypalëshe, si simpoziume, konferenca dhe seminare;
- shkëmbimit të kërkuesve;
- shkëmbimit të informacionit dhe publikimeve;
- aktiviteteve të tjera shkencore për të cilat *Palët* bien dakord në proces, përmes memorandumeve të veçanta të bashkëpunimit.

Neni 3

Zbatimi i memorandumit të mirëkuptimit (MoU)

Palët bashkëpunojnë në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar në fuqi dhe sipas burimeve financiare të destinuara për këtë Memorandum.

Neni 4

Caktimi i koordinatorëve të programit

Secila *Palë* cakton një koordinator të programit si pikë kryesore të kontaktit për realizimin e bashkëpunimit dypalësh dhe zbatimin e këtij *Memorandumi*.

Neni 5

Shkëmbimi i kërkuesve

Palët nisen nga besimi se shkëmbimet reciproke të kërkuesve janë të dobishme për vendet e tyre. Në përzgjedhjen e studiuesve pjesëmarrës në aktivitetet e shkëmbimit, *Palët* marrin parasysh si rëndësinë e kërkimeve të tyre, ashtu edhe ndikimet e mundshme të vizitave të tyre në zhvillimin e qendrave kërkimore specifike në Turqi dhe Shqipëri. Kërkuesit vizitues zgjidhen mbështetur në kapacitetin dhe kompetencën për të stimuluar dhe përmirësuar bashkëpunimin shkencor midis dy vendeve në frymën e këtij memorandum. Shkëmbimet u mundësohen kërkuesve shkencorë dhe atyre zbatues - inxhinierëve të interesuar të zhvillojnë aktivitete bashkëpunuese me studiues nga vend tjetër dhe/ose për nevoja trajnimi.

Neni 6
Shkëmbimi i informacionit dhe publikimeve

Palët informojnë njëra-tjetrën për aktivitetet e tyre dhe zhvillimet në politikat e tyre shkencore e teknologjike, si dhe për takimet, simpoziumet, konferencat dhe seminarët e tyre. *Palët* shkëmbejnë botime dhe informacione shkencore që mund të jenë me interes të përbashkët.

Neni 7
Vazhdimi i bashkëpunimit

Përfaqësuesit e *Palëve* takohen në nivelin e komisioneve *ad hoc* kurdo që lind nevoja, në mënyrë alternative, në Turqi dhe/ose në Shqipëri, për të diskutuar dhe vlerësuar bashkëpunimin e vazhdueshëm në kuadër të këtij *Memorandumi*.

Neni 8
Vlefshmëria, kohëzgjatja, ndryshimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Ky *Memorandum* hyn në fuqi me nënshkrimin e tij dhe do të mbetet i vlefshëm për një periudhë 10 (dhjetë)-vjeçare. Vlefshmëria e tij zgjatet automatikisht për periudha të njëpasnjëshme edhe për 10 (dhjetë) vjet të tjera, nëse asnjëra nga *Palët* nuk njofton me shkrim se dëshiron përfundimin e vlefshmërisë së tij të paktën 6 (gjashtë) muaj para skadimit të këtij afati.


Memorandumi mund të ndryshohet në çdo kohë, me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të *Palëve*. Ndryshimet hyjnë në fuqi me të njëjtën procedurë e të njëjtin rregull përshtuar në paragrafin e parë të këtij neni.

Mosmarrëveshjet e mundshme në lidhje me zbatimin ose interpretimin e këtij *Memorandumi* zgjidhen në mënyrë miqësore, nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave ndërmjet *Palëve*.

Ky *Memorandum* lidhet me synimin për të rritur dhe zhvilluar bashkëpunimin shkencor ndërmjet *Palëve* dhe nuk përbën një marrëveshje ndërkombëtare të detyrueshme për shtetet e pjesëmarrësve sipas ligjit ndërkombëtar. Asnjë dispozitë e këtij *Memorandumi* nuk interpretohet e zbatohet si krijim të drejtash a angazhimesh ligjore për shtetet e *Palëve*.

Secila *Palë* mund të përfundojë këtë *Memorandum mirëkuptimi* në çdo kohë, duke i dërguar *Palës* tjetër një njoftim me shkrim për këtë qëllim. Në këtë rast, *Memorandumi* ndërpritet jo më parë 6 (gjashtë) muaj pas datës së marrjes së njoftimit.

Nënshkruar në *Stamboll* më *20.4*.2024, në tre kopje origjinale, në gjuhën turke, në shqip dhe anglisht, me autenticitet të barabartë. Në rast të ndonjë mospajtimit në interpretim, teksti në anglisht është referencial.




Akademine e Shkencave të Turqisë
(TÜBA)

Prof. dr. Muzaffer Şeker
President

Për:

Akademine e Shkencave të Shqipërisë
(ASHSH)



Acad. Skënder Gjinushi
Kryetar